



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. _____ prot. _____

Tiranë, më 13.7.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion.

ZNJ. D

XH

QENDRA PËR GAZETARI CILËSORE

Të dhënat e kontaktit: e-mail

Tel: +

E nderuar znj. Xh.

Nga koordinatori për të drejtën e informimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, është përcjellë kërkesa juaj për informacion, datë 24.6.2022, e cila është protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. _____ prot., datë 29.6.2022, dëshirojmë t'ju informojmë se:

Objekti i kërkesës suaj dhe pyetjet e listuara, bëjnë pjesë në kategorinë e informacioneve të cilat bëhen publik, pa pasur nevojë për një kërkesë me shkrim drejtuar autoritetit publik. Kjo bazuar në nenin 4, pika 7 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe nenet 6 dhe 7, pika 1, paragrafët "k" dhe "l", të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Në kuadër të 5-vjetorit të konstituimit të tij, në datën 17 qershor 2022, Komisioni ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, raportin statistikor të vendimmarrjes së tij, bazuar në kategori vendimesh dhe kategori subjektsh, referuar linkut <https://kpk.al/ep-content/uploads/2022/06/Raporti-5-vjecar.pdf>.

Komisioni, duke qenë se e vlerëson të rëndësishme transparencën me median dhe publikun, ju informon se deri në 30 qershor 2022, ka dhënë gjithsej **540 vendime**, nga të cilat:

- **210** vendime për konfirmimin në detyrë të **106** gjyqtarëve, **92** prokurorëve, **2** ish-inspektorëve në KLD, **1** inspektori në KLGJ dhe 9 ndihmësve/këshilltarë ligjorë;
- **204** vendime për shkarkimin nga detyra të **123** gjyqtarëve, **77** prokurorëve, **1** inspektori në ILD, **1** inspektor KLGJ dhe **2** ndihmësve ligjorë;
- **80** vendime për ndërpjerje të procesit për **40** gjyqtarë, **21** prokurorë, **2** ish-inspektorëve në KLD dhe 7 ndihmësve ligjorë + **1** ish-prokurori. (Neni 171 Aneksit të Kushtetutës);

- **35** vendime për përfundimin e procesit për **22** gjyqtarë, **11** prokurorë dhe **1** ish-Kryeinspektori i KLD-së dhe 1 ish-Inspektori ILD (neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative dhe neni 64 i ligjit nr. 96/2016);
- **8** vendime për pushimin e procesit për **3** gjyqtarë, **1** prokuror dhe **4** ndihmës ligjorë në Gjykatën e Lartë (neni 56 i ligjit nr. 84/2016);
- **3** vendime për pezullimin nga detyra të 3 prokurorëve.

Deri më 30 qershor 2022, Komisioni në total si shkallë e parë e rivlerësimit ka kryer procesin bazuar mbi 3 kritere (pasuri, figurë dhe profesional) për **347 subjekte** (gjyqtarë, prokurorë, ndihmës/këshilltarë ligjor dhe inspektorë); me 2 kritere janë rivlerësuar **20 subjekte**; me 1 kriter janë rivlerësuar gjithsej **57 subjekte** (56 subjekte me kriterin pasuror dhe 1 vetëm me kriterin e figurës). Deri më sot, Komisioni nuk ka shkarkuar nga detyra asnjë subjekt rivlerësimi vetëm për kriterin profesional.

Pjesa më e madhe e vendimeve të shkarkimit nga detyra, u përket atyre subjekteve që nuk kanë mundur të kalojnë filtrin për kriterin e pasurisë, apo dhe filtrat ligjorë të dy kritereve të tjer, figurë/profesional.

Për detaje të hollësishme, në faqen tonë zyrtare, kategoria “Vendime”, <https://kpk.al/vendime/> ju mund të aksesoni lirisht përmbajtjen e çdo vendimi të arsyetuar me shkrim, për secilin subjekt rivlerësimi që i është nënshtruar procesit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Lidhur me pyetjen tuaj të fundit dhe bazuar në dispozitat e Kushtetutës dhe Aneksit të saj, si dhe dispozitat e ligji nr. 84/2016, ligjvënësi u ka parshikuar të drejtën e ankimit subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, kundër vendimit të KPK-së. Ankimet kundër vendimmarjes së Komisionit, shqyrtohen në shkallën dytë të rivlerësimit, nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Nga fillimi deri më 30 qershor 2022, në total, kanë ankimuar vendimet e KPK-së **217 subjekte**, ku bëjnë pjesë të gjithë subjektet e shkarkuara, si dhe disa nga subjektet të cilët janë dorëhequr sipas nenit nenit G të Aneksit kushtetues, apo u ka përfunduar procesi pa një vendim përfundimtar. **119** prej tyre janë **gjyqtarë** të shkarkuar, të cilët kanë ankimuar vendimin e Komisionit në KPA.

Për informacione të tjera ju mund të aksesoni faqen zyrtare dhe vendimet e arsyetuara me shkrim nga trupat gjykuese për secilin subjekt rivlerësimi që i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar.

Duke ju falënderuar, ju urojmë punë të mbarë!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

